



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.506/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit NPT “Art – Com” me seli ne Pejë, me NUI 810426735, ndaj debitorit “MAB” me seli ne Pejë, me NUI 810549157, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës, Departamenti i Ekonomik, KPPP.nr.384/23 te datës 27.11.2023, me datën 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit “MAB” me seli ne Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës, Departamenti i Ekonomik, KPPP.nr.384/23 i datës 27.11.2023, **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Gjykata Komerciale e Kosovës, Departamenti i Ekonomik, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.384/23 te datës 27.11.2023, e ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit “MAB” me seli ne Pejë, i paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.302/2022 dt.20.12.2022 te Përmbaruesit Privat Zija Bala, për territorin e Gjykatës Themelore ne Pejë dhe ka lënë ne fuqi urdhrin përmbarimor P.nr.302/22 dt.20.12.2022.

Kundër këtij aktvendimi, ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj këtë ankesë, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe urdhrin përmbarimor te shfuqizoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë, e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

- **Ankesa e debitorit është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori më datën 20.12.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës me nr. 001523/2020 date 13.10.2020, për shumën e mjeteve 3323.52 euro, Faturës me nr. 001524/2020 date 16.11.2020, për shumën e mjeteve 690.72 euro, Faturës me nr. 001585/2020 date 27.11.2020, për shumën e mjeteve 918.24 euro, Faturës me nr. 001589/2020 date 01.12.2020, për shumën e mjeteve 864.36 euro, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit nga fatura, t'i paguaj shumën e kredis se kërkuar si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Kundër urdhrit përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 18.01.2023, arsyetimin se, propozimi për përmbartim është përpiluar në mënyrë të jo të rregullt. Duke pretenduar se nga faturat e lëshuara, e të cilat janë dokument përmbartimor në këtë çështje janë të parregullta, nga të njëjta nuk vërtetohet fakti se a ka arritur detyrimi për përmbartje, perkatesisht e është maturuar kërkesa e debitorit. Propozon që gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit, urdhrin përmbartimor ta shfuqizoj si edhe të gjitha veprimet përmbartimore.

Përgjigje në prapësimin e debitorit, ka paraqitur kreditori me pretendimin që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar, pasi që ka për qëllim prolongimin e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbartimor duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Gjykata arsyeton se fatura mbi të cilën bazohet propozimi për përmbartim i plotëson të gjitha kushtet ligjore konform nenit 29 dhe 37 të LPP. Pra urdhri përmbartimor bazohet në dokument të besueshëm. Andaj gjykata e shkallës së parë, vkeresin se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore të parapara me nenin 71 të LPP, andaj konform nenit 71 dhe 73 të LPP ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të saj.

Dhoma e Shkallës së Dytë, e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës - me nr. 3/1/2020 të datës 18.05.2020 Faturës me nr. 001523/2020 date 13.10.2020,

për shumën e mjeteve 3323.52 euro, Faturës me nr. 001524/2020 date 16.11.2020, për shumën e mjeteve 690.72 euro, Faturës me nr. 001585/2020 date 27.11.2020, për shumën e mjeteve 918.24 euro, Faturës me nr. 001589/2020 date 01.12.2020, për shumën e mjeteve 864.36 euro, të lëshuar nga kreditori, në mbështetje të nenit 29 par.3 i LPP i cili thotë, se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbarrjes së detyrimit monetar”*, kjo faturë ka cilësinë e dokumentit të besueshëm dhe e njëjta si e tillë paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 21 të njëjtit ligj. Propozimi për përmbarrim i ushtruar nga kreditori, po ashtu rezulton të jetë në pajtim me nenin 37 të LPP-së e cila thotë se *“kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimi të bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së dytë, i vlerësoj edhe pretendimet ankimore, mirëpo nga shkresat e lëndës konstatoj se propozimi për përmbarrim është hartuar në mënyrë të rregullt, e po ashtu debitori e ka pranuar faturën në mënyrë të rregullt.

Gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në bazë të dokumentit të besueshëm, të cilën kreditori ia ka bashkëngjitur me rastin e ushtrimit të propozimit për përmbarrim, janë plotësuar kushtet ligjore për caktimin e përmbarrimit dhe se kjo faturë ligjërisht paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarrimit.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi edhe pretendimet e debitorit se gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar drejt provat e paraqitura nga ana e të paditurës, ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike e njëkohësisht ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, por vlerësoi se këto pretendime nuk qëndrojnë, sepse debitori nuk i ka argumentuar me prova konkrete ashtu siç parasheh neni 69 par.4 i LPP, dhe se të tilla nuk ndikojnë në një vendosje ndryshe për çka kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara, ndërsa aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë e vërtetoi.

Përndryshe, në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles së Dytë
K.DH.SH.II nr.506/24 me datë 04.06.2024**

**Gjyqtari,
Faton Bajrami**